



Datë: 23.03.2026  
Numër Protokolli: 1439/2026

A.nr.150/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.150/2026 të datës 09.02.2026 të parashtruar nga ankuesi L.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Vitisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.03.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.150/2026, e datës 09.02.2026, e parashtruar nga ankuesi L.H.

**II. Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër 01/26, i datës 15.01.2026, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën “*Zyrtar për Çështje Psikologjike*” në Komunën e Vitisë.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil L.H, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 09.02.2026, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 688/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018886, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar për Çështje Psikologjike*”, në Komunën e Vitisë, me pretendimet ankimore se procesi është zhvilluar në mënyrë jo transparente respektivisht nuk i është dhënë qasje në dokumente publike, pretendon se Komisioni i pranimit ka konflikt të interesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa kjo e fundit me datë 26.02.2026 është përgjigjur me shkresat e bashkëngjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit)** administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 688/2026 të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Përgjigjen e datës 26.02.2026; Kopjen e Konkursit RN00018886; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe akt emërimet; Lista e kandidatëve pjesëmarrës; Dosjen e ankuesit dhe kandidates fituese; Testin me shkrim të kandidatit fitues; Rezultatet e testit me shkrim; Formularët e vlerësimit për intervistën verbale, nga secili anëtar i Komisionit; Rezultatet përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin e datës 15.01.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Vitisë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Vitisë, më datë 20.10.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00018886, për pozitën e punës “Zyrtar për Çështje Psikologjike”- Klasa Profesional 2, me afat aplikimi nga data 21.10.2025 deri me datë 19.11.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 4 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa prej tyre 3 kandidatë i kanë plotësuar kushtet për të vazhduar fazën e testimit, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili në testimin me shkrim ka marrë gjithsejtë 39,2 pikë, prej tyre 28 pikë në pyetje opcionale dhe 11,2 pikë në ese që nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kaluar në fazat e mëtejme.

Tutje, përmes Njoftimit me numër 01/26, i datës 15.01.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të organit përkatës të punësimit, rezulton se kandidatja M.A, me gjithsejtë 92,2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidatë fituese për pozitën “Zyrtar për Çështje Psikologjike”- në Komunën Vitisë.

Ankuesi, kundër zhvillimit të kësaj procedure rekrutimit ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore sikurse janë shënuar në hyrje të këtij arsytimi.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00018886, për pozitën e punës “Zyrtar për Çështje Psikologjike”- Klasa Profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor): Shkenca të Psikologjisë; Kërkesat Specifike: Nuk ka. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** Gjithë ashtu Kolegji ka shqyrtuar përbërjen e Komisionit të pranimit në shërbimin civil të Komunës së Vitisë dhe ka konstatuar se Komisioni i pranimit është në përputhje me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht me nenin 40 ku

përcaktohet se “..1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për praninë në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësi përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Në dritën e thënieve si më lartë, Kolegji ka konstatuar se konkursi me numër të referencës RN00018886 është shpallur në përputhje me Rregulloren 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe Katalogun e vendeve të punës ku kjo pozitë evidentohet me nr. SHCK-1085

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankueses si më sipër, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën një nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”, prandaj nga shkresat e lëndës konstatohet se ankuesi nuk ka arritur të kaloj testimin me shkrim ku ka arritur 39,2 pikë, dhe për ankuesin nuk është kontestuese testimi me shkrim.*

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, se Komuna e Vitisë nuk i ka dhënë qasje në dokumentet të cilat i ka kërkuar, fillimisht Kolegji konstaton se për këtë pretendim nuk është kompetent, POR me qëllim të trajtimit të lëndës së ankuesit KPMSHCK ka kërkuar dosjen e hollësishme nga organi i punësimit respektivisht Komuna e Vitisë dhe të njëjtit me datë 26.02.2026 kanë sjellë dosjen për këtë ankesë me shkresat e bashkëngjitura, ndërsa testimin me shkrim të ankuesit e kanë sjellë me datë 13.03.2026, pas kërkesës së KPMSHCK, ankuesi për të siguruar shkresat ka mundur sipas afateve ligjore të drejtohet në Agjencinë për Privatësi, ky pretendim i ankuesit në bindjen e Kolegjit nuk e dëmtuar në asnjë rrethanë procesin e rekrutimit, sepse Kolegji ka pasur qasje në të gjitha dokumentacionin e nevojshëm.

Ankuesi pretendon për ekzistencën e konfliktit të interesit në mesë anëtarëve të komisionit dhe kandidates së zgjedhur sepse janë të një përkatësie politike, në këtë kuptim Kolegji ju referua Ligjit 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht neni 29 ku përcaktohet se “ Rastet e përjashtimit nga procedura 1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në një nga këto situata: 1.1. Kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo; 1.2. kur bashkëshorti apo partneri bashkëjetues, apo të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë; 1.3. kur është vetë palë,

*përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebitor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës; 1.4. nëpunësi apo personat e parashikuar nga nën paragrafi 1.2. i këtij neni, kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë; 1.5. personat e përmendur në nën paragrafin 1.2. të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë, dëshmitarë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë; 1.6. ndërmjet nëpunësit apo personave të përmendur në nën paragrafin 1.2. të këtij neni, ka një proces gjyqësor me palët; 1.7. nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur në nën paragrafin 1.2 të këtij neni; 1.8. nëpunësi ose personat e përmendur në nën paragrafin 1.2 të këtij neni, kanë përfituar dhurata apo shërbime me një çmim dukshëm me të ulët se vlera e tregut, nga palët në procedurën administrative, përpara ose pas fillimit të procedurës; 1.9. me palën, përfaqësuesin apo të autorizuarin e palës, është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit apo të ushqyesit; 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”, **prandaj** referuar këtij neni secili nga anëtarët e komisionit që gjendet në këtë situata do duhet të paraqesë me shkrim, ndërsa nga shkresat e lëndës nuk konstatohet se ndonjëri nga anëtarët e Komisionit të pranimit të ketë kërkuar përjashtim nga procedura e rekrutimit dhe si i tillë pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.*

Kolegji me qëllim të konstatimit se kandidatja fituese në këtë procedurë të rekrutimit ka plotësuar kushtet formale të parapara në konkurs ka shqyrtuar dosjen e kandidates M.A dhe ka konstatuar se e njëjta posedon diplomën nr.105/18 sipas të cilës ka përfunduar studimet më datë 16.09.2018 dhe ka marrë gradën Bachelor në Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, e njëjta ka përvojë pune si vijon nga data 12.01.2022 Drejtoresh në Drejtorin për Shëndetësi dhe Punë Sociale deri më datë: 14.12.2025, ngase u tha Kolegji konstaton se kandidatja M.A ka plotësuar kushtet formale të konkursit sipas pikës 3.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi me numër 01/26, të datës 15.01.2026, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidates fituese për pozitën “Zyrtar për Çështje Psikologjike”, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA, A.nr.150/2026**

**Ilire Mehmti-Shaqiri**

Procesmbajtëse

**Eshref Shabani**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit, L.H;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.